

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas një njoftimi për përqendrim të parashtruar nga SALUS tregtimin e produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. Lubjanë me seli në Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjana, Slloveni, dorëzuar përmes avokatit Martin Ivanov nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.02.2023, solli

AKTVENDIM

1.Vërtetohet se përqendrimi me të cilin SALUS- tregtim i produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. Lubjana me seli në Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjana, Slloveni, do të fitojë kontrollin e vetëm mbi MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. me seli në rrugën Brnçiçeva 17B, 1231 Lubjana - Çrnuçe, Slloveni, përmes shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2.Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 26.01.2023, plotësuar më 03.02.2023 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga SALUS- tregtimin e produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. Lubjanë me seli në Litostrojska cesta 46A, 1000 Lubjana, Slloveni, ku SALUS- tregtim i produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. do të fitojë kontrollin e vetëm mbi MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. me seli në rrugën Brnçiçeva 17B, 1231 Lubjana - Çrnuçe, Slloveni, përmes shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

- **SALUS- tregtim i produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. Lubjana** është një shoqëri me seli në Lubjanë dhe shoqëri mëmë e Grupit Salus. Grupi Salus gjeneron shumicën e të ardhurave të tij përmes ndërmarrjeve-bijë të tij SALUS -tregti me shumicë d.o.o. dhe Sanolejbor d.d. aktiviteti kryesor i të cilit është tregtia me shumicë (SALUS- Tregtia me shumicë dhe Sanolejbor) dhe tregtia me pakicë (Sanolejbor) e barnave, produkteve farmaceutike, ndihmave mjekësore, pajisjeve dhe materialeve mjekësore. Shoqëritë brenda Grupit Salus ofrojnë gjithashtu shërbime magazinimi, rregullatorë, shërbime farmakovigjilence, marketing dhe promovim farmaceutik, farmakoekonomi. SALUS -tregtim i produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. Ljubljana (si shoqëri mëmë e Grupit Salus) është aktive kryesisht në fushën e investimeve dhe menaxhimit të pasurive të paluajtshme.

Në Maqedoninë e Veriut, SALUS -tregtim i produkteve farmaceutike, mjekësore dhe të tjera, a.d. aktivitetet e veta afariste i ushtron përmes ndërmarrjes-bijë të saj, Shoqëria për tregti, përfaqësim dhe marketing CARCO PHARM SHPKNJP Ilinden me seli në rrugën 34 nr.5, Ilinden. Aktivitetet e tij janë përfaqësimi dhe marketingu i markave tregtare të prodhuesve kryesorë të produkteve farmaceutike.

- **MEDITREJD, Shoqëria për tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o.** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me seli në Lubjanë. Shoqëria është aktive në tregtimin me shumicë të pajisjeve mjekësore. Klientët kryesorë të shoqërisë janë institucionet shëndetësore, me të cilat shoqëria synon, ndër të tjera, të kontribuojë në një nivel të lartë të kujdesit shëndetësor për popullatën.

MEDITREJD, Shoqëria për Tregti të jashtme dhe të brendshme d.o.o. nuk ka mjete dhe nuk ka bërë asnjë qarkullim në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски